



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 88000-00115-00-2017 Regj. Themeltar
Nr. __Vendimi**

V E N D I M

“Për nisjen e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqësore”

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Sandër SIMONI	Kryesues
Sokol BINAJ	Anëtar
Medi BICI	Anëtar

Sot në datën 10.06.2022, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale me nr. 88000-00115-00-2017, akti, që i përket palëve:

KËRKUES: Shaban Kokaj

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë

OBJEKTI: Mosekzekutimi i vendimit penal të formës së prerë duke u përjashtuar nga vuajtja e dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të vendimit Nr. 67 datë 22.11.1991 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për të dënuarin Shaban Kokaj.

BAZA LIGJORE: Neni 68/a i K. Penal dhe nenet 480 dhe vijues të K.Pr.Penale

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Sandër Simoni, prokurorin pranë Prokurorisë së Përgjithshme z. Arqile Koça, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër duke pranuar kërkesën e kërkuesit, avokatin Bledar Bajri, i cili kërkoi prishjen e vendimit nr. 10, datë 26.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe vendimit nr. 168, datë 07.11.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe shuarjen e dënimit të dhënë me vendimin nr. 67, datë 22.11.1991 në ngarkim të shtetasit Shaban Koka për kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit si dhe shuarjen e vendimit nr. 63, datë 14.10.2013 të

Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për efekt parashkrimi dhe deklarimin e pavlefshëm të vendimit nr. 96, datë 11.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se, kërkuesi Shaban Kokaj, me vendimin nr. 67, datë 22.11.1991, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është dënuar me 18 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje për motive të dobëta”. Ai është arrestuar në datën 07.11.1990. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 18.01.1992. Kërkuesi pas vuajtjes së një pjese të dënimit, është arratisur nga vendi i vuajtjes së dënimit në Mars të vitit 1997, gjatë trazirave të vitit 1997. Në datën 06.04.2009 i dënuari është arrestuar sërish dhe është vendosur në burgun e Burrelit për vazhdimin e ekzekutimit të dënimit të mbetur.

2. Në datën 19.02.2013, i dënuari Shaban Kokaj nuk është kthyer në vendin e vuajtjes së dënimit në I EVP Burrel, pas lejes shpërblyese të miratuar nga ky institucion. Me vendimin nr.63, datë 14.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat kërkuesi është dënuar me 4 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”. Ndërsa me vendimin nr.96, datë 11.11.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur bashkimin e dënimit të mbetur pa vuajtur (5 vjet e 8 muaj) me dënimin e dhënë si pasojë e largimit të kërkuesit (4 vjet), duke e dënuar përfundimisht me 9 vjet e 8 muaj burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 22.11.2013.

3. Kërkuesi Shaban Kokaj, nëpërmjet mbrojtësit të tij i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë me kërkesë me objekt: “Mosekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë duke u përjashtuar nga vuajtja e dënimit për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të vendimit nr. 67, datë 22.11.1991 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 67, datë 22.11.1991 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është parashkruar meqenëse kanë kaluar 20 vjet nga momenti i marrjes formë të prerë të këtij vendimi. Sipas kërkuesit, data e fillimit të afatit të parashkrimit për të dënuarin Shaban Kokaj është data 18.01.1992, kur vendimi ka marrë formë të prerë dhe data e parashkrimit të ekzekutimit të këtij vendimi është data 19.01.2012. Në lidhje me vendimin nr. 96, datë 11.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat me të cilin është bërë bashkimi i dënimeve kjo gjykatë ka gabuar me bashkimin e dënimeve pasi ka bashkuar një dënim të parashkruar që në datën 19.02.2013.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin nr.10, datë 26.05.2014, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. Kundër vendimit lejohet ankimi nga palët brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit Shkodër*”.

4.1 Gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka arsyetuar se: “*Gjykata pasi çmoi në tërësi provat e nënshtruara shqyrtimit gjyqësor konkludon se kërkesa është e pabazuar në ligj dhe në prova e për këtë shkak duhet rrëzuar. Nga provat e nënshtruara shqyrtimit gjyqësor provohet se kërkuesi Shaban Kokaj është dënuar me 18 vjet burgim me vendimin nr. 67 datë 22.11.1991 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë për veprën penale të “Vrasjes me dashje për motive të dobëta”. Ky vendim penal ka marrë formë të prerë me datë 18.01.1992. Nga ky moment fillon afati i ekzekutimit të vendimit në bazë të nenit 68 të K. Penal. Duke marrë në konsideratë se sipas vendimit penal kërkuesi është dënuar me 18 vjet burgim gjykata konstaton se në bazë të pikës a të nenit 68 ekzekutimi i dënimit nuk mund të realizohet pas 20 vjetësh nga data që vendimi ka marrë formë të prerë, pra pas datës 19.02.2012. Rezultoi e provuar gjatë gjykimit se kërkuesi Shaban Koka ka filluar vuajtjen e dënimit penal dhe më pas ai është larguar nga*

institucioni i vuajtjes së dënimit për shkak të trazirave të vitit 1997. Nga dinamika e vuajtjes së dënimit, e konfirmuar dhe nga shkresa me nr. 197 B prot, datë 04.02.2014 e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve provohet se kërkuesi është kapur dhe ka filluar vuajtjen e pjesës së mbetur të dënimit me datë 06.04.2009. Duke marrë parasysh kohën kur kërkuesi ka rifilluar vuajtjen e dënimit (datë 06.04.2009) dhe afatin ligjor të parashkrimit të dënimit sipas nenit 68 pika a e K. Penal (datë 18.01.1992 – datë 19.02.2012) gjykata konstaton se në kohën kur i dënuari ka rifilluar vuajtjen e dënimit nuk kishte përfunduar ende afati i parashkrimit të dënimit. Ndërsa në datën 19.02.2013 kur ai është larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit afati i parashkrimit të këtij vendimi ka përfunduar. Por, duke qenë përpara faktit që ka një vendim gjykate (vendimin nr. 96 datë 11.11.2013 të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat) i cili ka marrë formë të prerë në datë 22.11.2013 me të cilin është vendosur bashkimi i dënimeve duke llogaritur në këtë bashkim edhe pjesën e dënimit të pavuajtur për dënimin e parë, gjykata çmon të theksojë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat në vendimin e saj e ka pranuar faktin se ky vendim penal nuk është parashkruar përderisa ajo ka disponuar duke i bashkuar këto dënime. Duke u ndodhur përpara këtij fakti gjykata vlerëson se jemi përpara rastit kur një gjykate e të njëjtës shkallë si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat është shprehur në lidhje me këtë çështje edhe pse në mënyrë të nënkuptuar, duke mos e konstatuar të parashkruar këtë vendim penal përderisa ka bërë bashkimin e tij. Për këtë arsye Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë nuk mund të disponojë për një çështje e cila është zgjidhur me një vendim të një gjykatë tjetër të së njëjtës shkallë i cili ka marrë formë të prerë sepse nuk është ankimuar nga palët. Nëse gjykata do të vepronte në këtë mënyrë do të cënonte dhe një nga parimet më themelore të të drejtës penale siç është parimi i gjësë së gjykuar. Kompetenca për të shqyrtuar një çështje e cila është zgjidhur me vendimin nr. 96 datë 11.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat i përket vetëm një gjykate të një shkalle më të lartë siç është Gjykata e Apelit. Ndodhur në këto kushte kur jemi përpara faktit të ekzistencës së një vendimi penal me të cilin është bërë bashkimi i dënimeve i cili ka marrë formë të prerë, afati i parashkrimit për rastin konkret do të fillojë nga data kur ky vendim i bashkimit të dënimeve ka marrë formë të prerë që është data 22.11.2013. Si përfundim, gjykata çmon se kërkesa objekt gjykimi duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj dhe në prova”.

5. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 168, datë 27.11.2014, ka vendosur: “Lënie në fuqi të vendimit nr.10, datë 26.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë”.

5.1 Gjykata e apelit ndër të tjera ka arsyetuar se: “Vendimi nr. 10 datë 26.05.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është i bazuar në ligj dhe në prova e si i tillë duhet të lihet në fuqi. Nën dritën e parashikimit të bërë nga neni 68 i Kodit Penal, nga Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë si dhe nga rrethanat e faktit, arrihet në përfundimin se në parim, është parashkruar ekzekutimi i vendimit penal të dhënë me vendimin nr. 67, datë 22.11.1991 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. I dënuari ka vuajtur vetëm një pjesë të vuajtjes së dënimit gjatë afatit kohor 22 vjeçar, pasi është larguar 2 herë nga vendi i vuajtjes së dënimit. Së dyti: Gjykata e shkallës së parë, në shqyrtimin e kërkesës për shuarje të dënimit për efekt të parashkrimit, me të drejtë ka mbajtur në konsideratë rrethanat e reja që janë vërtetuar pas largimit në mënyrë të paligjshme nga vendi i vuajtjes së dënimit nga kërkuesi Shaban. Ky shtetas, është gjetur fajtor dhe dënuar për kryerjen e veprës penale "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit", neni 323/1 i Kodit Penal, me vendimin nr. 63, datë 14.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, duke u dënuar me 4 (katër vjet burgim). Me një tjetër vendim gjyqësor të formës së prerë, atë me nr. 96, datë 11.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është bërë bashkimi i pjesës së pavuajtur të dënimit të parë me dënimin e dhënë rishtaz. Në përfundim të atij gjykimi, shtetasit Shaban Kokaj i është caktuar një dënim i vetëm prej 9 vjet e 8 muaj

burgim. Ky vendim i fundit, ka marrë formë të prerë e disponimet e tij nuk mund të ndryshohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, gjykatë e të njëjtës shkallë me të, apo Gjykata e Apelit Shkodër, e cila nuk ka në juridiksionin e saj çështjet e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë Mat”.

6. Kundër vendimit nr. 168, datë 27.11.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs kërkuesi Shaban Kokaj, duke kërkuar prishjen e vendimit nr.10 datë 26.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe vendimit nr. 168 datë 27.11.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe shuarjen e dënimit të dhënë ndaj të pandehurit Shaban Kokaj, duke pretenduar ndër të tjera këto shkaqe:

- Në bazë të nenit 68/a të K. Penal vendimi nr. 67, datë 22.11.1991 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është parashkruar meqenëse kanë kaluar 20 vjet nga moment i marrjes formë të prerë të këtij vendimi.
- Më konkretisht data e fillimit të afatit të parashkrimit për të dënuarin Shaban Kokaj është data 18.01.1992 kur ka marrë formë të prerë vendimi nr. 67, datë 22.11.1991 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe data e parashkrimit të ekzekutimit të këtij vendimi është data 19.01.2012.
- Ky vendim është parashkruar dhe nuk mund të ekzekutohet më pas datës 19.01.2012 pasi ka kaluar afati 20 vjeçari parashikuar nga neni 68/a i K. Penal.
- Dënimi i dhënë me vendimin penal nr. 67 datë 22.11.1991 është parashkruar në datën kur i pandehuri nuk është rikthyer për të vuajtur dënimin.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka bërë gabim kur ka bërë bashkim dënimesh për faktin që vendimi i parë ka qenë i parashkruar, e për pasojë ky bashkim është nul.
- Arsytimi i vendimit se nuk jemi para parashkrimit nëqoftëse ka ndodhur bashkimi i dënimeve nuk qëndron pasi afatet e parashkrimit nuk pezullohen dhe as zgjaten për asnjë lloj shkak ose arsye, qëndrim i mbajtur nga Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr. 7 datë 11.10.2002.

7. **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë**, me vendimin nr. 447, datë 05.03.2015, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Shaban Kokaj nëpërmjet mbrojtësit të tij, kundër vendimit nr. 168 datë 27.11.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër”.*

8. Kërkuesi Shaban Kokaj i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në të trija shkallët e gjyqimit duke parashtruar ndër të tjera se:

- Arsytimi i vendimit të Gjykatës së Apelit është kontradiktor, pasi nga njëra anë, kjo gjykatë pranon se është parashkruar ekzekutimi i vendimit të formës së prerë dhe, nga ana tjetër, lë në fuqi vendimin e gjykatës së faktit që ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit.
- Nga ana e gjykatës së faktit dhe Gjykatës së Apelit nuk është zbatuar drejt ligji material që lidhet me institutin e parashkrimit. Ky veprim i gjykatave vjen në kundërshtim me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, konkretisht me vendimin nr. 7, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
- Gjykata e Lartë, në kundërshtim me nenin 68/a të Kodit Penal (KP), edhe pse jemi në kushtet e zbatimit të gabuar të ligjit, nuk e ka pranuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi.

9. **Gjykata Kushtetuese** me vendimin nr. 84 datë 13.10.2016 ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.447, datë 05.03.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare”.*

9.1 Gjykata Kushtetuese ndër të tjera ka arsyetuar se:

Gjykata, në funksion të kontrollit të respektimit të standardit për akses në gjykim, vlerëson të shprehet paraprakisht për kuptimin kushtetues të cenimit të lirisë së individit dhe të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, si dhe për pasojat që ai sjell ndaj procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë.

Gjykata konstaton se në datën e largimit të kërkesit nga vendi i vuajtjes së dënimit (19.02.2013) afati i ekzekutimit të dënimit të tij ishte parashkruar, pasi kishin kaluar 20 vjet nga momenti kur vendimi nr.67, datë 22.11.1991 kishte marrë formë të prerë. Në këto kushte, kur nga momenti që vendimi ka marrë formë të prerë kanë kaluar 20 vjet, ekzekutimi i dënimit konsiderohet i parashkruar.

Gjykata vëren se moszbatimi i dispozitave penale në kontekstin e fakteve të pranuar, ka cënuar kërkesin në të drejtat e tij kushtetuese të parashikuara nga nenet 27 dhe 42 të Kushtetutës, si pasojë e një gjykimi jo të drejtë, duke i kufizuar atij lirinë dhe duke cënuar kështu edhe sigurinë juridike.

Gjykatat e faktit, megjithëse e kanë konstatuar parashkrimin në vendimet e tyre, kanë arsyetuar “*stricto sensu*” se ato janë përpara një vendimi gjyqësor të formës së prerë, i cili nuk e ka konstatuar parashkrimin dhe për këtë arsye ato nuk mund të disponojnë mbi çështjen, pasi do të cënonin parimin e gjësë së gjykuar. Sipas tyre, duke qenë se ka një vendim penal të formës së prerë, me të cilin është bërë bashkimi i dënimeve afati i parashkrimit do të fillojë nga data kur vendimi i bashkimit të dënimeve ka marrë formë të prerë. Në vlerësim të Gjykatës ky arsyetim i gjykatave të faktit e ka vendosur kërkesin në situatën ku atij i duhet të vuajë një dënim i cili është parashkruar. Këto shkelje të bëra nga gjykatat e faktit nuk janë konstatuar as nga Gjykata e Lartë...

Gjykata vëren se edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesi ka evidentuar faktin se ekzekutimi i vendimit të dënimit nr.67, datë 22.11.1991 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është parashkruar, për arsye se kanë kaluar 20 vjet nga momenti i marrjes formë të prerë të vendimit. Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (shih vendimet nr.35, datë 20.12.2005; nr.14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë...

Pavarësisht kësaj, Gjykata e Lartë ka vendosur në dhomën e këshillimit mospranimin e rekursit, duke mos u shprehur dhe mos u dhënë përgjigje këtyre pretendimeve me natyrë kushtetuese. Gjykata për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet nr.19, datë 19.07.2005; nr.22, datë 06.06.2011; nr.18, datë 14.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se përderisa në rekurs ishin ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë duhej të shprehej mbi to në respektim të rolit të saj kontrollues dhe parimit të subsidiaritetit.

Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se në çështjen konkrete Gjykata e Lartë ka lejuar një proces të parregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës,

duke mos ushtruar funksionin e saj kontrollues për respektimin e standardeve kushtetuese të procesit të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

10. Përpara Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është paraqitur për shqyrtim çështja penale nr.88000-00115-00-2017 Akti, e dërguar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e cila me vendimin nr.84, datë 30.12.2016, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së paraqitur nga kërkuuesi Shaban Kokaj duke shfuqizuar vendimin nr. 447, datë 05.03.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.

11. Çështja penale me nr. 88000-00115-00-2017 akti, me objekt të përsëritur në pjesën hyrëse të këtij vendimi, ka ardhur për gjykim në Gjykatën e Lartë, pas shqyrtimit të saj nga ana e Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 84 datë 13.10.2016, ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.447, datë 05.03.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.”*

12. Kolegji Penal bazuar në nenin 437 pika 1, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, në të cilën citohet se: *“1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se: b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Penal thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes në rastet e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të nenit 432 të këtij Kodi”*, vlerësoi të marrë në shqyrtim rekursin e të dënuarit Shaban Kokaj në seancë gjyqësore me praninë e palëve, për shkak të konstatimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të vendimmarrjeve të gjykatave të themelit dhe të Gjykatës së Lartë në kundërshtim me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7/2002.

13. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, palët kërkuar respektivisht mbrojtja e kërkuarit/të dënuarit prishjen e vendimit nr. 10, datë 26.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe vendimit nr. 168, datë 07.11.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe shuarjen e dënimit të dhënë me vendimin nr. 67, datë 22.11.1991 në ngarkim të shtetasit Shaban Kokaj për kohën e mbetur të pavuajtur të dënimit si dhe shuarjen e vendimit nr. 63, datë 14.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për efekt parashkrimi dhe deklarimin e pavlefshëm të vendimit. Prokuroria e Përgjithshme kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Gjykatës së Apelit Shkodër duke pranuar kërkesën e kërkuarit.

14. Pretendimet e ngritura në rekurs bien në fushën e përcaktuar në pikën “c” të nenit 432 K.Pr.Penale e cila parashikon si një ndër shkaqet e rekursit *“kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë”*. Duke iu referuar akteve të kësaj çështjeje e cila permbledh në vetvete problematika të zbatimit të ligjit penal material por dhe procedural, identifikohen një sërë çështjesh të cilat kjo gjykatë do të duhet t’u japë zgjidhje apo të mbajë një qëndrim të caktuar.

15. Kolegji Penal vlerëson se duhet të mbajë një qëndrim në lidhje me raportin që kjo gjykatë do të mbajë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese kur vëren në arsyetimin e saj qëndrime që dalin tej kufirit të juridiksionit kushtetues, si duhet të interpretohen prej saj dhe a është e ndaluar kjo gjykatë që, pas një vendimi të tillë, të ushtrojë juridiksionin kushtetues të interpretimit të ligjit. Në lidhje me interpretimin e ligjit penal, në rastin konkret mbi zbatimin e

nenit 68 të K.Pr.Penale, ka qenë se ky pretendim nuk binte në fushën e shqyrtimit kushtetues por ishte tagër e shqyrtimit të gjykatave të zakonshme.

16. Megjithatë, sikurse konstatohet, Gjykata Kushtetuese, jo vetëm që ka shqyrtuar aspektet e procesit të rregullt ligjor po ka arsyetuar në një farë mënyre dhe në lidhje me interpretimin e ligjit material dhe të raportit të tij me faktet kur në paragrafët 24 dhe 25 është shprehur: “ 24. Gjykata konstaton se në datën e largimit të kërkuesit nga vendi i vuajtjes së dënimit (19.02.2013) afati i ekzekutimit të dënimit të tij ishte parashkruar, pasi kishin kaluar 20 vjet nga momenti kur vendimi nr.67, datë 22.11.1991 kishte marrë formë të prerë. Në këto kushte, kur nga momenti që vendimi ka marrë formë të prerë kanë kaluar 20 vjet, ekzekutimi i dënimit konsiderohet i parashkruar. 25. Gjykata vëren se moszbatimi i dispozitave penale në kontekstin e fakteve të pranuar, ka çënuar kërkuesin në të drejtat e tij kushtetuese të parashikuara nga nenet 27 dhe 42 të Kushtetutës, si pasojë e një gjykimi jo të drejtë, duke i kufizuar atij lirinë dhe duke çënuar kështu edhe sigurinë juridike”.

17. Kolegji Penal, vlerëson se arsyetimet e mësipërme të bëra nga Gjykata Kushtetuese, duhet të interpretohen në raport me funksionin e saj dhe fushën e gjykimit që Kushtetuta i njeh asaj gjykate dhe që nuk përbën një shkak ndalues për ushtrimin nga Gjykata e Lartë të juridiksionit të saj mbi rastin. Analiza dhe interpretimi i mësipërm i bërë nga Gjykata Kushtetuese, nuk ka patur si synim interpretimin dhe zgjidhjen për se të rastit por, është përdorur si një rrugë arsyetimi për të evidentuar shkeljen e të drejtave themelore të individit, atë të aksesit në gjykatë, apo parimin e sigurisë juridike nga refuzimi për t'i dhënë përgjigje përfundimtare pretendimeve të vlerësuara si të natyrës kushtetuese, të kërkuesit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në këtë kuptim, kjo gjykatë do të marrë në konsideratë arsyetimet e tjera të Gjykatës Kushtetuese në raport me disponimin e saj mbi shkelje të procesit të rregullt ligjor dhe detyrimit për shqyrtimin e rekursit por nuk është e lidhur domosdoshmërisht me arsyetime të Gjykatës Kushtetuese për çështje që janë në juridiksionin e saj.

18. Në lidhje me diskutimin nëse i dënuari mund të përfitojë nga parashkrimi i ekzekutimit të dënimit në rastet kur ky dënim është bashkuar me një dënim për të cilin nuk ka kaluar afati i parashkrimit të ekzekutimit, Kolegji arsyeton se disponimi i gjykatës për bashkimin e dënimeve dhe përcaktimi i një dënimi të vetëm nuk përbën një dënim në kuptimin klasik të fjalës. Ky disponim përfaqëson rezultatin e aplikimit të një teknike zbatimi të dënimit në rastet kur ka më shumë se një të tillë. Për këtë arsye ky disponim është i aplikueshëm dhe në rastin kur individit është gjykuar e dënuar në një kohë për dy ose më shumë vepra penale ashtu dhe në rastin kur këto dënime janë dhënë në kohë të ndryshme.

19. Në këtë kuptim, neni 68 i K.Pr.Penale, në rastet kur flet për parashkrim të ekzekutimit të dënimit nënkupton dënimin e caktuar si rezultat i një gjykimi të një çështje penale të mirëfilltë ku në përfundim të tij për veprën penale të gjykuar, është akorduar një dënim i caktuar. Kjo sjell si rrjedhojë që diskutimi mbi parashkrimin merr për bazë datën kur vendimi për dënimin e personit për një veprë penale të caktuar, ka marrë formë të prerë në mënyrë individuale dhe jo mbi bazën e vendimit të formës së prerë që ka bashkuar dy a më shumë vendime. Kjo, pasi ligjvënësi, duke përcaktuar afate të ndryshme për masa të ndryshme dënimesh, në mënyrë të tërthortë e lidh afatin e parashkrimit me veprën penale të kryer. Po kështu, nga pikëpamja teorike, është pranuar se nëpërmjet këtij instituti, ligjvënësi pasqyron faktin se, me kalimin e një kohe të caktuar, ai nuk është më i interesuar për ekzekutimin e një dënimi të dhënë për një sjellje të caktuar penale në një kohë të caktuar.

20. Në lidhje me diskutimin nëse ndodhemi para gjësë së gjykuar në rastin kur në shqyrtimin e kërkesës për bashkim dënimesh nuk është shqyrtuar dhe disponuar për parashkrimin

e ekzekutimit të një prej vendimeve, rezulton se qëndrimi i mbajtur nga gjykatat më të ulta, është se fakti që parashkrimi nuk është konstatuar kryesisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me rastin e vendimmarrjes për bashkimin e dënimeve, përbën, në mënyrë të tërthortë, një disponim prej saj edhe për mosparashkrimin e ekzekutimit. Kjo nuk përkon me qëndrimin e mbajtur në praktikë deri më tani në lidhje me kuptimin e drejtë të konceptit *res judicata*. Nëse një çështje është ose jo gjë e gjykuar nuk mund të nxirret nëpërmjet deduksioneve. Teoria dhe praktika gjyqësore ka pranuar se për të patur gjë të gjykuar është e domosdoshme të jenë të pranishme tre elementë: - personi i njëjtë;- fakti i shqyrtuar i njëjtë; - disponimi i njëjtë. Në rastin konkret konstatohet se edhe pse personi është i njëjtë, faktet e shqyrtuara dhe disponimet janë të ndryshme. Është e vërtetë që gjykata e Matit edhe kryesisht mund ta shqyrtonte dhe të dispononte për parashkrimin, por duhet kuptuar se kjo është një e drejtë e saj dhe jo një detyrim në kushtet kur asnjëra nga palët nuk e ka ngritur këtë pretendim.

21. Në lidhje me diskutimin nëse kërkuesi përfiton nga parashkrimi i ekzekutimit të vendimit objekt kërkese, në rrethanat faktike dhe ato ligjore në fuqi, duhen interpretuar parashkrimet e nenit 68 të K.Penal si dhe Vendimin nr. 7 të vitit 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të kësaj gjykate. Në rastin në shqyrtim kërkuesi Shaban Kokaj, me vendimin nr. 67, datë 22.11.1991, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, është dënuar me 18 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje për motive të dobëta”. Ai është arrestuar në datën 07.11.1990. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 18.01.1992. Kërkuesi pas vuajtjes së një pjese të dënimit, është arratisur nga vendi i vuajtjes së dënimit në Mars të vitit 1997, gjatë trazirave të vitit 1997. Në datën 06.04.2009 i dënuari është arrestuar sërish dhe është vendosur në burgun e Burrelit për vazhdimin e ekzekutimit të dënimit të mbetur. Në datën 19.02.2013, i dënuari Shaban Kokaj nuk është kthyer në vendin e vuajtjes së dënimit në I EVP Burrel, pas lejes shpërblyese të miratuar nga ky institucion. Me vendimin nr.63, datë 14.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat kërkuesi është dënuar me 4 vjet burgim për kryerjen e veprës penale “Largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”. Ndërsa me vendimin nr.96, datë 11.11.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur bashkimin e dënimit të mbetur pa vuajtur (5 vjet e 8 muaj) me dënimin e dhënë si pasojë e largimit të kërkuesit (4 vjet), duke e dënuar përfundimisht me 9 vjet e 8 muaj burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 22.11.2013. Për gjykatat e faktit këto përbëjnë arsye të moszbatimit të parashkrimit.

22. Gjykatat e faktit kanë arsyetuar se “*Duke marrë parasysh kohën kur kërkuesi ka rifilluar vuajtjen e dënimit (datë 06.04.2009) dhe afatin ligjor të parashkrimit të dënimit sipas nenit 68 pika a e K. Penal (datë 18.01.1992 – datë 19.02.2012) gjykata konstaton se në kohën kur i dënuari ka rifilluar vuajtjen e dënimit nuk kishte përfunduar ende afati i parashkrimit të dënimit. Ndërsa në datën 19.02.2013 kur ai është larguar nga vendi i vuajtjes së dënimit afati i parashkrimit të këtij vendimi ka përfunduar. Por, duke qenë përpara faktit që ka një vendim gjykate (vendimin nr. 96 datë 11.11.2013 të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat) i cili ka marrë formë të prerë në datë 22.11.2013 me të cilin është vendosur bashkimi i dënimeve duke llogaritur në këtë bashkim edhe pjesën e dënimit të pavuajtur për dënimin e parë, gjykata çmon të theksojë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat në vendimin e saj e ka pranuar faktin se ky vendim penal nuk është parashkruar përderisa ajo ka disponuar duke i bashkuar këto dënime. Duke u ndodhur përpara këtij fakti gjykata vlerëson se jemi përpara rastiit kur një gjykate e të njëjtës shkallë si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat është shprehur në lidhje me këtë çështje edhe pse në mënyrë të nënkuptuar, duke mos e konstatuar të parashkruar këtë vendim penal përderisa ka bërë bashkimin e tij.” Gjykata e Lartë nuk e ka kaluar për shqyrtim rekursin e paraqitur ndaj këtyre vendimeve.*

23. Gjykata Kushtetuese, duke arsyetuar në një farë mënyre dhe në lidhje me interpretimin e ligjit material dhe të raportit të tij me faktet është shprehur: *“në datën e largimit të kërkuesit nga vendi i vuajtjes së dënimit (19.02.2013) afati i ekzekutimit të dënimit të tij ishte parashkruar, pasi kishin kaluar 20 vjet nga momenti kur vendimi nr. 67, datë 22.11.1991 kishte marrë formë të prerë. Në këto kushte, kur nga momenti që vendimi ka marrë formë të prerë kanë kaluar 20 vjet, ekzekutimi i dënimit konsiderohet i parashkruar”*, si dhe duke konstatuar më tej se ky qëndrim i gjykatave është në kundërshtim me praktikën e unifikuar me Vendimin nr. 7/2002 të Kolegjeve të Bashkuara.

24. Në kushtet kur Gjykata e Lartë është e detyruar të zbatojë Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, përpara se ti japë përgjigje çështjeve të konstatuara sa më sipër, vlerëson që të ngrejë çështjen e nevojës së ndryshimit të praktikës gjyqësore të unifikuar mbi parashkrimin e ekzekutimit të vendimit penal pavarësisht nga shkaku i mosekzekutimit të vendimit për shkak të mosvënies në ekzekutim apo ndërprejes së tij nga rrethana të tjera. Pikërisht në këtë pikë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson të ndalet në Vendimin nr. 7/2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

25. Kolegji konstaton se Vendimi Unifikues nr. 7/2002 i Kolegjeve të Bashkuara është një vendim detyrues për praktikën gjyqësore, e si i tillë është zbatuar gjatë gjithë kësaj periudhe nga koha kur është marrë si vendim. Ky vendim është dhënë duke patur parasysh fenomenin e largimit nga institucionet e vuajtjes së dënimit të të dënuarve në vuajtje e sipër të dënimit, gjatë ngjarjeve të vitit 1997, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme në vend, në kushtet e mungesës së rendit dhe sigurisë. Ndërkohë çështja në rekursin në shqyrtim pranë këtij Kolegji, ka të bëjë me rastin e fillimit të ekzekutimit të vendimit penal dhe ndërprejes së tij për shkak të lejes shpërblyese të dhënë gjatë ekzekutimit të tij.

26. Gjatë zbatimit të Vendimit Unifikues 7/2002, në praktikë ka patur vështirësi në identifikimin e pjesës konstatuese unifikuese. Vendimi në fjalë nuk ka identifikuar qartë pjesën konstatuese të ngritur për unifikim dhe pjesën e sentencës së unifikuar, ndërkohë që ka identifikuar¹ si gjetje *“Në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet ndërprerja e ekzekutimit”* dhe *“Zbatimi i ligjit penal me analogji nuk lejohet”* të cilat në vetevete nuk përbëjnë çështje të interpretimit ligjor por konstatim të asaj ç’farë ligji penal material ka parashikuar. Ndërkohë që në pjesën e parë të vendimit janë ngritur si probleme ligjore që duhej të gjenin trajtim në këtë vendim : *Kur është i zbatueshëm instituti i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit: a) vetëm në rast se vendimi penal nuk është vënë asnjëherë në ekzekutim b) apo edhe në rastet kur vendimi është vënë në ekzekutim dhe nuk është përmbushur plotësisht.*

27. Në brendësi të arsyetimit² jo i identifikuar qartësisht gjendet shprehja: *“Kolegjet e Bashkuara arritën në përfundimin se edhe duke u nisur nga interpretimi logjik i shprehjes nga ligjvënësi në dispozitën e këtij neni ku thuhet; “Vendimi i dënimit nuk ekzekutohet kur nga dita që ka marrë formë të prerë kanë kaluar...”, nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për asnjëlloj shkaku. Kjo vlen si për rastet kur ky vendim i dënimit nuk është vënë fare në ekzekutim, ashtu edhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim dhe pasi i dënuari ka filluar të vuajë dënimin, vuajtja e mëtejshme e tij ndërpritet për çfarëdo lloj shkaku sikurse mund të jetë edhe largimi i të dënuarit nga vuajtja e dënimit, siç ka ndodhur me të dënuarin B.L.”*. Vendimi ka dhe një mendim pakice të disa gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të

¹ Shënimet me ngjyrë të theksuar të shprehjeve në faqen 5 të Vendimit Nr. 7 datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

² Në paragrafin 6 të faqes 5 të Vendimit Nr. 7 datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

cilët identifikojnë në mendimin e tyre si çështje interpretative nocionet ligjore të “pezullimit”, “zgjatje”, “ndërprerje të parashkrimit” dhe kuptimin e parimit të moslejimit të zbatimit të ligjit penal me analogji.

28. Në zbatim të këtij vendimi, në praktikën gjyqësore është marrë si pjesë unifikuese pikërisht pjesa e sipërcituar e arsytimit të tij, identifikuar në përfundimin “*nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për asnjë lloj shkak. Kjo vlen si për rastet kur vendimi i dënimit nuk është vënë fare në ekzekutim, ashtu dhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim dhe pasi i dënuari ka filluar të vuajë dënimin, vuajtja e mëtejshme e tij ndërpritet për çfarëdo lloj shkak, sikurse mund të jetë dhe largimi i të dënuarit nga vuajtja e dënimit*”. Ky përfundim i arritur në këtë vendim është zbatuar si i tillë nga gjykatat në interpretim të nenit 68 të KP edhe në çështjen që është në shqyrtim para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

29. Neni 66 i KP është ndryshuar me ndryshimet e vitit 2017,³ duke zgjatur afatin e parashkrimit të ndjekjes penale për disa vepra penale, ndërsa në nenin 68 të KP nuk ka patur ndryshime. Ndërkohë që një bllok i gjerë i normave penale materiale kanë ndryshuar e paralele me to rregullimet për ekzekutimet e vendimeve penale janë ndryshuar shpesh deri në ato të fundit të vitit 2020.⁴ Ndryshimet dinamike të bëra në legjislacionin penal dhe atë procedural penal të viteve të fundit e kryesisht ato që kanë lehtësuar mënyrën e vuajtjes së dënimit me burgim, sikurse është rasti konkret i dhënies së lejeve shpërblyese nuk janë bërë në mënyrë organike në mënyrën se si afektohen dispozitat e tjera të këtij legjislacioni duke krijuar në këtë mënyrë anomali funksionale. Këto anomali nuk mund të zgjidhen nga kjo gjykatë pasi do të krijonte rrezikun e marrjes së tagrave ligjvënëse por se kjo problematikë mund të vihet në dispozicion të strukturave ligjbërëse për marrjen e masave në ndryshimin dhe përmirësimin e legjislacionit.

30. Për Kolegjin Penal Vendimi Unifikues nr. 7/2002, ka tejkaluar kuptimin që vetë ligji i kishte dhënë institutit të parashkrimit, duke u interpretuar si i tillë jo në mënyrë korrekte lidhur me momentin e llogaritjes së afateve të parashkrimit në kushtet kur ekzekutimi i dënimit ka filluar e për shkaqe të ndryshme ndërpritet. Interpretimi i bërë ligjit penal nga Kolegjet e Bashkuara dhe unifikimi i praktikës gjyqësore sipas këtij vendimi barazon si rastin kur ekzekutimi i dënimit nuk ka filluar ashtu dhe atë kur ai ka filluar dhe është ndërprerë për çdo shkak.

31. Sipas këtij Vendimi Unifikues nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për asnjë lloj shkak. Kjo vlen si për rastet kur vendimi i dënimit nuk është vënë fare në ekzekutim, ashtu dhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim dhe pasi i dënuari ka filluar të vuajë dënimin, vuajtja e mëtejshme e tij ndërpritet për çfarëdo lloj shkak, sikurse mund të jetë dhe largimi i të dënuarit nga vuajtja e dënimit. Si shkak i tillë mund të jetë p.sh arratisja nga vendi i kryerjes së dënimit apo dhe marrja e lejes shpërblyese nga i dënuari e moskthimi më në vendin e vuajtjes së dënimit duke konsumuar në këtë mënyrë elementët e një figure tjetër vepre penale.

32. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se nisur nga koha e gjatë e kaluar nga marrja e këtij vendimi, konteksti kohor në të cilin është marrë dhe ndryshimet e vullshme legjislative të viteve të fundit, kjo praktikë gjyqësore e deritanishme duhet ndryshuar. Në këtë kontekst zbatimi i mëtejshëm në gjykatat i vendimit unifikues të sipërcituar në këtë formë, nuk

³ Ndryshuar me ligjin nr 36/2017 datë 30.03.2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. “

⁴ Ligji nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”

është në përputhje me përmbajtjen e nenit 68 të KP, dhe do të sillte rrezik për sigurinë në sistemin penitenciar. Në interpretimin krahasues të normave penale Kolegji ka konstatuar tashmë se janë tejkaluar disa nga konceptet e vjetra të interpretimit të ngushtë strico senso të tyre duke i dhënë legjislacionit material penal një kuptim më të gjerë e të kohës. Pikërisht për këtë çështje Kolegji Penal konstaton se jurisprudenca e vendeve të tjera të cilat kanë legjislacion penal material të ngjashëm me tonin shkojnë në këtë frymë. Praktika njësuere e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë tashmë ka pranuar konceptin e “ndërprerjes së parashkrimit” edhe në interpretimin e normave materiale penale e procedurale.⁵

33. Në kushtet e mungesës së ndërhyrjes legjislative nga ligjvënësi, Kolegji Penal vlerëson se në këtë rast Gjykata e Lartë duhet të shfrytëzojë funksionin e vet ligjor e kushtetues si rregullator në njësimin, ndryshimin e zhvillimin e një praktike gjyqësore që i përgjigjet kontekstit kohor e zhvillimit të interpretimit ligjor në kohë. Këtë funksion i ka përcaktuar Kushtetuta Gjykatës së Lartë më ndryshimet e vitit 2016 e të reflektuara në ndryshimet procedurale të vitit 2021⁶.

34. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e vitit 2016⁷ përcakton se: *“Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet sipas ligjit”*.

35. Neni 438 i KPrP⁸ parashikon se *“Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore... Vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Penal ose i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruar për njësimin ose praktikën gjyqësore të njësuar që duhet ndryshuar - Vendimi publikohet menjëherë pas arsytimit në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë. Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegji ku marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve nga sekretaria gjyqësore sipas rregullave të njoftimit të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të seancës”*.

36. Paragrafi 2 i nenit 441 të KPrP,⁹ parashikon se *“Në rastet kur Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore në vendim gjykata fomulon edhe rregullin e së drejtës për cdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë rast vendimi botohet në Fletoren Zyrtare”*

37. Sa sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson që bazuar në nenin 438 pag.1 i K.Pr.P, të nisë procedurën për ndryshim të praktikës gjyqësore në lidhje me vendimin unifikues

⁵ Vendimi Njësues i datës 7.04.2022 I Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në lidhje me rehabilitimin.

⁶ Ligji nr. 41/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, ligji i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 71 datë 14.05.2021 dhe hyrë në fuqi në datën 30.05.2021.

⁷ Ligji nr. 76/2016 “Për një ndryshim në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”

⁸ Njësimi dhe ndryshimi i praktikës gjyqësore, ndryshuar me nenin 34 të ligjit nr. 41/2021 datë 23.03.2021

⁹ I ndryshuar me nenin 36 të ligjit nr. 41/2021 datë 23.03.2021

nr.7 të vitit 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë sipas të cilit “*nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për asnjë lloj shkak. Kjo vlen si për rastet kur vendimi i dënimit nuk është vënë fare në ekzekutim, ashtu dhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim dhe pasi i dënuari ka filluar të vuajë dënimin, vuajtja e mëtejshme e tij ndërpritet për çfarëdo lloj shkak, sikurse mund të jetë dhe largimi i të dënuarit nga vuajtja e dënimit*”, lidhur me momentin e llogaritjes së afateve të parashkrimit në kushtet kur ekzekutimi i dënimit ka filluar e për shkaqe të ndryshme ndërpritet.

38. Në bazë të këtij vendimi të ndërmjetëm duhet njoftuar Kryetari i Kolegjeve të Bashkuara për caktimin e datës, orës së gjykimit të çështjes për ndryshim të praktikës gjyqësore, duke njoftuar palët si dhe publikimin e vendimit të ndërmjetëm menjëherë në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 438 parg.1 i K.Pr.P

VENDOSI:

- Nisjen e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqësore në lidhje me Vendimin Unifikues nr.7 të vitit 2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë sipas të cilit “**Nuk mund të ketë zgjatje të afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit për asnjë lloj shkak. Kjo vlen si për rastet kur vendimi i dënimit nuk është vënë fare në ekzekutim, ashtu dhe për rastet kur ky vendim është vënë në ekzekutim dhe pasi i dënuari ka filluar të vuajë dënimin, vuajtja e mëtejshme e tij ndërpritet për çfarëdo lloj shkak, sikurse mund të jetë dhe largimi i të dënuarit nga vuajtja e dënimit**”, lidhur me momentin e llogaritjes së afateve të parashkrimit në kushtet kur ekzekutimi i dënimit ka filluar dhe për shkaqe të ndryshme ndërpritet.

- Njoftimin e Kryetarit të Kolegjeve të Bashkuara për caktimin e datës, orës së gjykimit të çështjes për ndryshim të praktikës gjyqësore, duke njoftuar palët.

- Publikimin e vendimit të ndërmjetëm menjëherë në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

Tiranë, më 10.06.2022